



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr. 92, datë 17.06.2019

PËR

**SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR.61, DATË 24.04.2019, TË KËSHILLIT TË LARTË
GJYQËSOR “PËR FILLIMIN E PROCEDURËS SË TRANSFERIMIT TË
PËRKOHSHËM DHE SHPALLJEN E NJË POZICIONI TË LIRË TË PËRKOHSHËM
PËR TRANSFERIM NË GJYKATËN E RRETHIT GJYQËSOR KURBIN”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetur në nenin 97, pika 3, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në nenin 116 të Kodit të Procedurave Administrative, në konsideratë të shtesave dhe ndryshimeve të bëra në Vendimin nr. 23, datë 07.02.2019 të KLGJ-së “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”, nëpërmjet Vendimit nr. 86, datë 11.06.2019, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.23, datë 07.02.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit”, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

VENDOSI:

1. Të shfuqizojë Vendimin nr.61, datë 24.04.2019, “Për fillimin e procedurës së transferimit të përkohshëm dhe shpalljen e një pozicioni të lirë të përkohshëm për transferim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin”, si dhe të procedurave të ndjekura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR